

Ju sapo kaluat një test tuberkulinik (ose injeksion intradermik të tuberkulinës). Ky test lejon vlerësimin e mbrojtjes së organizmit tuaj ndaj bacilit të Tuberkulozës, zbulimin e një Infeksioni Tuberkuloz latent (ITL) dhe për të vendosur nëse është e nevojshme të merrni një trajtim preventiv.

Në mënyrë që rezultatet të jenë sa më të sakta duhet të vëreni disa rregulla.

Për dijeninë tuaj :

Leximi i testit bëhet pas 72 orësh prandaj nuk duhet të shqetësoheni nëse xhunga që rezulton pas injeksionit zmadhohet gjatë 48 orëve të para. Leximi i testit bëhet nga një mjek ose nga një infermiere.

Testi tuberkulinik nuk jep temperature dhe nuk shkakton lodhje. Nga ana tjetër mund të shfaqet një skuqje e lëkurës që shoqërohet me kruajtje.

Rregullat që duhen vërejtur :

- Të hiqni leukoplastin rreth 30 minuta pas injeksionit
- Mos e kruani zonën e injeksionit. Në rast se ju kruhet, futeni krahun në ujë të ftohtë
- Mos vini asgjë mbi zonën e injeksionit (krem me kortikoide, desinfektues, peeling ...)

SHENJAT E TUBERKULOZES

Shenja të përgjithshme :

- Djersë gjatë natës
- Ethe
- Rënie të gjendjes së përgjithshme :
 - ✓ rënie nga pesha
 - ✓ mungesë oreksi
 - ✓ lodhje të rëndë

Shenja të mushkërive :

- Pështymë me gjak
- Kollë e vazhdueshme 2-3 javë me rradhë pavarësisht nga mjekimet.
- Dhimbje të gjoksit

Këto simptoma mund të jenë shenjat paralajmëruese të sëmundjes së tuberkulozës

Në rast se keni këto simptoma, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj familjar ose CLAT-in.

Terapitë që ulin imunitetin si p.sh. një kortikoterapi e gjatë (më shumë se 10 mg në ditë) ose një kurë kundër Faktorit të Nekrozës Tumoralë -TNF- (Enbrel®, Rémicade®, Humira® ...) rrisin rrezikun e shfaqjes së tuberkulozës.

Qendra e Luftës Kundër Tuberkulozës e Mayenne (CLAT)

Centre Hospitalier de Laval

33 Rue du Haut Rocher

53000 LAVAL

☎ 02 43 66 50 55

✉ clat53@chlaval.fr